



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

08.08.2024

Drejtuar: “ALSTEZO” SH.A, me adresë: Lagjia Kryengritja e Fierit, Fier

Procedura e prokurimit: E hapur e thjeshtuar, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-11493-06-28-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 1 “Blerje pjesë këmbimi automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës”, me fond limit: 2,511,120 (dy milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 35 datë 8 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “AEE SERVICE” sh.p.k, me NUIS L81530012C dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,730,200 (një milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH;
2. “ALSTEZO” sh.a, me NUIS J63208420N dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,808,000 (një milion e tetëqind e tetë mijë) lekë pa TVSH;
3. “Amarildo Panda” p.f., me NUIS L73305411F dhe ofertë ekonomike me vlerë 2,468,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH;

4. “Auto Manoku Servis” sh.p.k., me NUIS L62311016C dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,883,340 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet) lekë pa TVSH;
5. “Besnik Meçi” p.f., me NUIS L12407012R dhe ofertë ekonomike me vlerë 2,391,800 (dy milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind) lekë pa TVSH;
6. “KADIU” sh.a., me NUIS J61817045K dhe ofertë ekonomike me vlerë 2,329,650 (dy milion e treqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH;

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. “Amarildo Panda” p.f., me NUIS L73305411F për arsyet e mëposhtme:

Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër. Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik ka paraqitur fatura tatimore shitje të ndryshme, të cilat nuk janë kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, referuar datës së lëshimit të tyre

2. “Auto Manoku Servis” sh.p.k., me NUIS L62311016C për arsyet e mëposhtme:

Nuk plotëson kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, pasi referuar kontratës së bashkëpunimit datë 27.11.2023, shoqëria “Auto Manoku” sh.a., me NUIS K92128001N ka marrë përsipër të vendosë në dispozicion të shoqërisë “Auto Manoku Servis” sh.p.k., automjetet e transportit që ka në pronësi, konkretisht automjetet me targë AB108DT dhe AA983RD.

Bazuar në angazhimin e paraqitur, me qëllim plotësimin e kërkesave të kërkuara në DST, gjendemi në kushtet e mbështetjes së kapaciteteve të një subjekti tjetër dhe bazuar në parashikimet e LPP (neni 84/4), AK duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.

Për këtë arsye në RrPP, në nenin 90, pika 2 është parashikuar:

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

Ndërsa në DT, shtojca 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, parashikohet që: Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Për sa më sipër referuar, me qëllim përmbushjen e parashikimeve ligjore në fuqi (sigurimin e AK se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij) shoqëria “Auto Manoku” sh.a., me NUIS K92128001N, në cilësinë e subjektit mbështetës duhet të kishte plotësuar dhe paraqitur një formular të veçantë vetëdeklarimi.

3. Operatori Ekonomik “AEE SERVICE” sh.p.k. me NUIS L81530012C s`kualifikohet për arsye se :

Oferta e paraqitur në Sistemin e Prokurimit Publik është vlerësuar anomalisht e ulët, pasi vlera e saj është më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, në bazë të nenit nr.82 së VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligjit nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, botuar ne fletoren zyrtare dt.04.03.2024 me nr.akti 16 dhe fletore zyrtare nr.40, neni 27 me përmasjtje “Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5, në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. “ALSTEZO” sh.a, me NUIS J63208420N dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,808,000 (një milion e tetëqind e tetë mijë) lekë pa TVSH

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a,me adresë: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, nr.3, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

